



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 9/2022 (JR)
Datë 15.02.2022

Vendim nr. 31 (JR)
Datë 27.07.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.07.2022, ditën e mërkurë, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra dhe avokatin e tij, z. Plator Bilibashi, të cilët kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në kuadër të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga grupi i punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilëve ka rezultuar:

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit *aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit*¹, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar si vijon: *i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ii. ka mosdeklarim pasurie ndër vite dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv. nuk ka kryer deklarim të rremë; v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht², ka konstatuar *përshatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gjon M. Kodra*. Në vijim të kërkesës së Komisionit, për përditësimin e raportit duke përfshirë informacionin e dërguar nga Shërbimi Informativ Shtetëror dhe deklasifikimin e tij, DSIK-ja përcjell raportin nr. {***} prot., datë 19.10.2021, të deklasifikuar pjesërisht³. Në këtë raport, citohet: *[...] për rastin në fjalë, konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.*

2.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë/ve, duke i dërguar Komisionit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar *për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra*.

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.10.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gjon Kodra, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

² Me vendimin nr. {***}, datë 09.07.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

³ Me vendimin nr. {***}, datë 20.10.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret”.

⁴ Raporti nr. {***} prot., datë 08.07.2020, “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra”.

3. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit:

3.1. *Ka kryer deklarim të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal (mosdeklarimi i pjesës takuese të pasurive të luajtshme e të paluajtshme të tij dhe të bashkëshortes dhe mosdeklarimi i burimit të krijimit/të ardhurave në deklaratat e pasurisë), konsiderohen si pasaktësi me peshë minimale dhe që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie.*

Nga analiza financiare, rezulton se me të ardhurat e fituara dhe shpenzimet e kryera, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 908.163 lekë, për periudhën 2003 – 2016, balancë e cila, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

3.2. *Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

3.3. *Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është i “aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

4. Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me vendimin nr. 491, datë 21.12.2021, vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

II. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Më datë 25.01.2022, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, është depozituar “Rekomandim për paraqitje ankimi”⁵, i nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”).
6. Në zbatim të rekomandimit, Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka ushtruar ankim⁶ kundër vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra. Nga shqyrtimi i vendimit nr. 491, datë 21.12.2021 dhe akteve shoqëruese, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat Komisioneri Publik çmon se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur juridiksionit kontrollues e rivlerësues të Kolegjit. Në zbatim të rekomandimit të ONM-së, të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit të posaçëm nr. 84/2016, Komisioneri Publik konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni, nuk janë të drejta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara.
- Nëpërmjet këtij mjeti procedural [ankimit], në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore të rivlerësimit kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, Komisioneri Publik synon

⁵ Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2022/01/22.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-491-dat%C3%AB-21.12.2021.pdf>.

⁶ Shih: <http://ikp.al/2022/02/08/ankim-kunder-vendimit-nr-491-date-21-12-2021-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-gjon-kodra/>.

kontrollin nga ana e Kolegjit të vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit lidhur me nevojën e rivlerësimit të çështjeve të ngritura në këtë ankim për të tria kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, figurës, aftësisë profesionale (*etika në lidhje me situatën e konfliktit të interesit*) dhe vlerësimin tërësor të çështjes.

7. Shkaqet e ngritura nga Komisioneri Publik në ankim, konsistojnë si më poshtë.

7.1. Për kriterin e pasurisë, në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 129 m², ndodhur në {***}, Tiranë, Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike, pretendon se:

7.1.1. Përfundimi i arritur nga Komisioni nuk gjen mbështetje në provat e administruara, ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit.

7.1.1.a. Lidhur me pagesën e shumës 35.952 euro në vitin 2006, me burim kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2005 – 2006 dhe 30.000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes:

- i.* Subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur, bashkëshortja, nuk kanë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar më 26.03.2004, dhe në deklaratat periodike për vitet 2004 dhe 2005, posedimin e kursimeve *cash* në shumën 35.000 euro, me burim të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003).
- ii.* Legjislacioni në fuqi për deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë [neni 4, germa “d” dhe neni 22 i ligjit nr. 9049/2003] ka rregullim të posaçëm në drejtim të përcaktimit të detyrimit dhe mënyrës për deklarim, qëllimi i të cilit është të monitorojë deklarimin dhe kontrollin e pasurive për subjektet deklaruuese dhe personat e lidhur me ta. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për paqartësi lidhur me plotësimin e formularëve të deklarimit për personin e lidhur, nuk gjejnë mbështetje në rrethana objektive.
- iii.* Në dosjen gjyqësore nuk është administruar asnjë provë/akt që të provojë posedimin e këtij kursimi, në shumën 35.000 euro. Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit, nuk rezulton që këto kursime të pretenduara të kenë qenë gjendje në llogaritë e saj bankare, apo të jetë provuar gjatë hetimit administrativ mënyra e transferimit të tyre në Shqipëri.
- iv.* Me referencë jurisprudencën⁷ e Kolegjit lidhur me deklaratimet e likuiditeteve *cash*, në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky kursim nuk duhet përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në vitin 2006, në shumën 35.952 euro, për një diferencë negative në shumën – 4.021.882 lekë.

7.1.1.b. Lidhur me pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2007, Komisioneri Publik vlerëson se:

- i.* Kjo shumë nuk mund të përfshihet në mesin e burimeve të ligjshme për sa kohë nuk është deklaruar posedimi i saj në deklaratat periodike për vitet 2003 – 2005. As në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar burimin e krijimit dhe as pakësim të likuiditeteve *cash*.
- ii.* Shumat prej 1.000 eurosh dhe 10.000 lekësh, të tërhequra nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, deri në kohën kur është bërë kjo pagesë, më 11.07.2007, janë të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të periudhës dhe pagimin e shumës 5.000 euro.

⁷ Shih vendimet nr. 27/2020 dhe nr. 1/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

iii. Bazuar në orientimin e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2019, Komisioneri Publik vlerëson se nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjekti i rivlerësimit, i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë që një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë në deklaratat periodike. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë se nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2007, në shumën 5.000 euro.

7.1.1.c. *Lidhur me pagesën e shumës 10.000 euro në vitin 2008*, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të pagesës prej 10.000 eurosh në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Referuar analizës financiare të kryer në Komision për vitin 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e kryer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 129 m², shpenzimet dhe kursimet e vitit, për një diferencë negative në shumën -563.752 lekë.

7.1.2. Bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b”, lidhur me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë.

7.2. *Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit*, Komisioneri Publik paraqet këto shkaqe ankimore:

- i. Përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm. Në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së, ndryshe nga konkluzioni i Komisionit, Komisioneri Publik vlerëson se marrëdhënia e interesit [detyrimet e ndërsjella juridiko-civile] ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. A. nuk kishte përfunduar në vitin 2008, por ka vazhduar në vitin 2010 e më tej në vitin 2016, me finalizimin e kontratës së shitblerjes.
- ii. Arsytimi i Komisionit nuk duhet të qëndrojë vetëm në kufijtë e konstatimit të një trajtimi preferencial, qoftë edhe ai me përfitime të dyanshme mes palëve, pasi trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit, por mund të ekzistojë edhe pa provuar atë situatë. Arsytimi i Komisionit se nuk u provua trajtimi preferencial në çmimin e apartamentit apo se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në pushimin e çështjes penale, ku iniciues ishte shtetasi A. A., u gjet e drejtë nga gjykata, duke treguar kështu se subjekti i rivlerësimit ka garantuar paanësinë e tij, nuk është përcaktuese, nëse ky përfundim nuk mbështetet në vlerësim tërësor të provave.
- iii. Me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit apo atij në dukje, subjekti i rivlerësimit duhet të hiqte dorë nga hetimi i procedimit penal nr. {***}, datë 24.06.2010. Në këtë kontekst, merr rëndësi dhe qëndrimi i subjektit në raport me detyrimin ligjor që ka pasur për të hequr dorë me veprime konkrete e jo sikundër ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, se ka vënë në dijeni drejtuesin e sektorit, por pa paraqitur asnjë akt provues, për të cilin vlen të përmendet praktika e Kolegjit në raste të ngjashme [vendimi (JR) nr. 10/2021, paragrafi 45].
- iv. Subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e heqjes dorë, me qëllim shmangien e çdo dyshimi për paanësinë e tij, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, që çon në një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë, sipas përcaktimeve të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, dhe në një vlerësim tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.3. Për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në rekomandimin e ONM-së, përmbajtjen e gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, e cila, referuar nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, përbën provë të barasvlershme me mendimin e një eksperti, duke e bërë këtë gjetje pjesë të shkaqeve të ankimit lidhur me kontaktin e subjektit të rivlerësimit me shtetasin P. A., person i përfshirë në krimin e organizuar, Komisioneri Publik çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm.

7.4. Duke vlerësuar një sërë mangësish të vërejtura për kriterin e pasurisë, konstatimin e ekzistencës së konfliktit të interesit, së bashku me problematikat për kriterin e figurës, kontaktit të papërshtatshëm, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, apo vlerësim tërësor të çështjes, konstatohet se zbatimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret, nuk është i bazuar.

7.5. Në përfundim të analizës së shkaqeve, Komisioneri Publik vlerëson se kontrolli i Kolegjit në këtë rast është i nevojshëm, duke vlerësuar shkaqet e këtij ankimi, si dhe gjetjen në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, që i përket shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
9. Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, janë ftuar palët pjesëmarrëse në këtë proces, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, që të depozitojnë në Kolegj parashtrimet e tyre me shkrim, së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe aktet t'u komunikohen përkatësisht palëve në proces, për dijëni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, për efekt të një ekonomie gjyqësore dhe të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor.
10. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 04.07.2022, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi që, në referim të paragrafit 26 të ankimit dhe të paragrafit 6 të parashtrimeve të Komisionerit Publik⁸, t'i kërkojë këtij të fundit të paraqesë analizën e plotë financiare për kriterin e kontrollit të pasurisë, brenda datës 12.07.2022. Gjithashtu, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë të akteve të listuara në parashtrimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit më datë 28.06.2022, konkretisht: *i.* deklaratën e z. E. M., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vërtetim nënshkrimi noterial nr. {***} rep., datë 22.06.2022; *ii.* urdhrin nr. {***}, datë 11.10.2010, “Për organizimin e prokurorëve dhe opgj-ve”; *iii.* procesverbalin e seancave gjyqësore të çështjes penale, me të pandehur shtetasin P. A., për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

⁸ Paragrafi 26 i ankimit: “Komisioneri Publik, në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së, datë 25.01.2022, pika “2”, gjen si të nevojshme kryerjen e një analize të plotë financiare nga ana e Kolegjit, për të gjitha vitet e deklaramit, në funksion të shkaqeve të këtij ankimi lidhur me kriterin e pasurisë”.

Paragrafi 6 i parashtrimeve të Komisionit Publik, datë 29.06.2022: “[...] Për efekt të gjykimit të kësaj çështjeje, Komisioneri Publik konstaton nevojën e kryerjes së një analize të plotë financiare nga ana e Kolegjit”.

11. Në përmbushje të detyrës së vendosur nga Kolegji, me vendimin e ndërmjetëm të datës 04.07.2022, Komisioneri Publik depozitoi më datë 06.07.2022, parashtrimet⁹ lidhur me analizën financiare. Në këto parashtrime, Komisioneri Publik u shpreh se i qëndron arsytimit në ankimin e datës 08.02.2022 dhe parashtrimeve të seancës gjyqësore publike të datës 04.07.2022 dhe, bazuar në rekomandimin e ONM-së, datë 25.01.2022, duke marrë në konsideratë prapësimet dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë seancës gjyqësore në Kolegj, ndan qëndrim të ndryshëm me analizën financiare të kryer nga Komisioni vetëm për sa i përket përfshirjes në të, të shumës 35.000 euro, me burim krijimi kursimet e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Si rezultat i mospërfshirjes në mesin e burimeve të ligjshme të kësaj shume, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në vitin 2006 do të rezultonin me një diferencë negative prej 4.021.882 lekësh për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e shumës 35.952 euro. Me mungesë burimesh të ligjshme, do të rezultonte dhe në vitin 2007, për pagesën e shumës 5.000 euro.
12. Në seancën gjyqësore publike të datës 18.07.2022, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, në referencë të *gjetjes* së paraqitur prej tij për kriterin e kontrollit të figurës, i drejtoi subjektit të rivlerësimit disa pyetje sqaruese lidhur me këtë kriter. Në vijim, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të verifikojë në burim, në institucionin ku është administruar informacioni në të cilin është bazuar *gjetja* e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar për kriterin e figurës, lidhur me vendimin e Komisionit. Duke qenë se ky veprim kryhet për administrimin e një informacioni të *klasifikuar*, ai bëhet pa prezencën e palëve pjesëmarrëse në gjykim. Në zbatim të vendimit të marrë, trupi gjykues, në datën 21.07.2022, kreu verifikimet pranë institucionit informues, për të dhënat e përcjella për subjektin e rivlerësimit, mbi të cilin është hartuar dhe “Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gjon M. Kodra” nr. {***} prot., datë 19.10.2021, i DSIK-së. Trupi gjykues ka mbajtur një procesverbal për njohjen me informacionin “Sekret shtetëror”, në ambientet e institucionit informues.
13. Në seancën gjyqësore publike të datës 22.07.2022, me bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit në zbatim të rekomandimit të ONM-së, të datës 25.01.2022, parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 04.07.2022, në vlerësim edhe të provave të administruara në kuadër të këtij gjykimi, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

14. Komisioneri Publik në ankim, sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, lidhur me apartamentin me sipërfaqe 129 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit. Komisioneri Publik pretendon mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të tria pagesat që subjekti i rivlerësimit ka kryer për shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij apartamenti, konkretisht në vitet 2006, 2007 dhe 2008. Në vijim, trupi gjykues ka analizuar shkaqet ankimore të Komisionerit Publik.
15. Lidhur me deklaramin e pasaktë, trupi gjykues konstaton se kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaramin e pasurisë *vetting*, si vijon: *Apartament me sipërfaqe 129 m², ndodhur [...] në {***}, pallati {***} ShPK [...]. Blerë me kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2016. Vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. {***}, datë lëshimi 21.10.2016. Nga rimatja e objektit para përpilimit të kontratës përfundimtare, ka rezultuar 11 metër katror më shumë se sa është pasqyruar në kontratën e shitblerjes së mëparshme 118 m². Vlera e kësaj*

⁹ Parashtrime nr. {***} prot., datë 06.07.2022, administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 06.07.2022.

diference do të zgjidhet me marrëveshje me investitorin e objektit në të ardhmen. Ky apartament është deklaruar më parë në kontratën e shitblerjes dhe vërtetimin përkatës të noterit R. K.. Vlera 50.952 euro. Pjesa takuese: 100%. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, burimi i krijimit të këtij apartamenti, duke mos përmbushur detyrimin e përcaktuar në dispozitat kushtetuese e ligjore, konkretisht nenin D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës¹⁰ dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin të plotësojnë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, në të cilën parashikohet qartësisht deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur këtë detyrim ligjor, përcaktuar në mënyrë të detajuar dhe në pikën 7 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së¹¹, sipas së cilës për çdo pasuri, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre, çojnë subjektin e rivlerësimit në situatën e një deklarimi të pasaktë, sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mosdeklarimi i burimit të krijimit të këtij apartamenti në deklaratën e pasurisë vetting, nuk vjen si pasojë e mungesës së burimit të ligjshëm, por në këtë deklaram është referuar dokumenti ligjor që është certifikata e pronësisë, pasi burimi i krijimit ishte deklaruar në deklaratat periodike në të cilat janë kryer pagesat [2006, 2007 dhe 2008], nuk u gjet nga trupi gjykues i bazuar në dispozitat kushtetuese e ligjore të sipërcituara. Këtë konkluzion e përforcon edhe më tepër fakti që as në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e kësteve 5.000 euro dhe 10.000 euro, sikurse është trajtuar në paragrafët 19 dhe 21 të këtij vendimi.

16. Sa i përket analizimit të shkaqeve ankimore që lidhen me mundësinë financiare për krijimin e kësaj pasurie, për pagesën prej 35.592 eurosh në vitin 2006, Komisioneri Publik pretendon se: i) subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur, bashkëshortja, nuk kanë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, dorëzuar më 26.03.2004, dhe deklaratat periodike për vitet 2004 dhe 2005, posedimin e kursimeve në “cash”, në shumën 35.000 euro, me burim të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003; ii) legjislacioni në fuqi për deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë [neni 4, germa “d” dhe neni 22 i ligjit nr. 9049/2003] ka rregullim të posaçëm në drejtim të përcaktimit të detyrimit dhe mënyrës për deklarim, qëllimi i të cilit është të monitorojë deklarimin dhe kontrollin e pasurive për subjektet deklaruese dhe personat e lidhur me ta. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për paqartësi lidhur me plotësimin e formularëve të deklarimit për personat e lidhur, nuk gjejnë mbështetje në rrethana objektive; iii) në dosjen gjyqësore nuk është administruar asnjë provë/akt që të provojë posedimin e këtij kursimi. Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes, nuk rezulton që këto kursime të pretenduara të kenë qenë gjendje në llogaritë e saj bankare, apo të jetë provuar gjatë hetimit administrativ, mënyra e transferimit të tyre në Shqipëri; iv) me referencë jurisprudencën¹² e Kolegjit lidhur me deklaratimet e likuiditeteve “cash”, ky kursim nuk duhet përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në vitin 2006 në shumën 35.952 euro, për një diferencë negative në shumën -4.021.882 lekë.
17. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, konstaton si vijon.

¹⁰ Neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin [...]”.

¹¹ Udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 [...]”.

¹² Shih vendimet nr. 27/2020 dhe nr. 1/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

17.1. Komisioni, duke vlerësuar faktin që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet e bashkëshortes nga punësimi, si burim krijimi për blerjen e apartamentit, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, pavarësisht se nuk i ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kushtet kur ka deklaruar të ardhurat nga punësimi si në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006 e nga viti 2008 e në vazhdim, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2010, ashtu dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke konsideruar faktin se bashkëshortja ka pasur të ardhura të ligjshme për të kursyer shumën 35.000 euro, arriti në konkluzionin se kjo shumë duhet përfshirë në analizën financiare, pavarësisht konfuzionit të subjektit për deklarimin e kësaj shume ndër vite. Mosdeklarimi i të ardhurave të bashkëshortes dhe i kursimeve të saj në deklaratat e interesave privatë 2004 dhe 2005, që në fakt janë deklaruar në vitin 2006, e prej vitit 2008 e në vazhdim, përfshirë edhe në deklaratën *vetting*, dokumente që në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 kanë vlerën e provës, si dhe në kushtet kur provohet bindshëm mundësia e bashkëshortes për kursimin e kësaj shume, konsiderohet nga Komisioni si pasaktësi në deklarim, e cila nuk vlerësohet deri në atë masë sa të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

17.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006: *Prenotim apartamenti me sipërfaqe 115,8 m², sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë {***} ShPK, me vlerë 50.952 euro [...] Pagaruar deri më 31.12.2006, 35.952 euro. Pjesa takuese: 50%. Ndryshe nga deklarata e pasurisë *vetting*, në deklaratën periodike 2006, rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të këtij apartamenti, konkretisht: i. duke përdorur kursime të deklaruara më parë në vitet 2005 – 2006; si dhe ii. shumën prej 30.000 eurosh, nga të ardhurat e b/shortes. Në të njëjtën deklaratë periodike, subjekti i rivlerësimit deklaroi detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj shoqërisë ndërtimore, në vlerën 15.000 euro, si dhe për herë të parë deklaroi të ardhura nga bashkëshortja A. L. (shtetase italiane) nga viti 1980 deri në vitin 1999. Kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri (Shkodër) si përfaqësuese e firmave italiane, në vlerën 35.000 euro.*

17.3. Referuar dokumentacionit mbi fitimin e pronësisë për këtë pasuri, dorëzuar me deklaratën e pasurisë *vetting*, përcjellë në Komision dhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore – Tirana Veri me shkresën nr. {***} prot., datë 13.08.2021, rezulton se fillimisht për këtë apartament është nënshkruar kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, apartament, e vitit 2006 [pa ekstremitete, nr. repertori/koleksioni, pa datë, e panëshkruar nga noteri R. K.]¹³ ndërmjet shoqërisë {***} ShPK, përfaqësuar nga administratori A. A., dhe blerësit Gjon Kodra, për pasurinë apartament nr. 4 (1+1), me sipërfaqe totale 115,8 m², ndodhur në rr. {***}, Tiranë. Sipas përcaktimeve në këtë kontratë të vitit 2006, së cilës subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006 dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, i është referuar si kontratë sipërmarrjeje, palët deklarojnë se çmimi i blerjes prej 50.952 eurosh është *likuiduar plotësisht nga blerësi në favor të shitësit, pa asnjë pretendim të mëtejshëm nga palët*. Nga aktet në dosjen gjyqësore bashkëlidhur kësaj kontrate, rezulton se është depozituar dokumenti *vërtetim*, i nënshkruar nga noteri R. K., nëpërmjet të cilit vërtetohet se pranë zyrës noteriale është depozituar kontrata e shitjes për apartamentin, lidhur mes palëve, shoqërisë {***} ShPK dhe z. Gjon Kodra, e cila do të qëndrojë e depozituar pranë kësaj zyre deri në momentin e nxjerrjes së dokumentit të pronësisë nga shoqëria sipërmarrëse/ndërtuese për këtë godinë banimi. Me nxjerrjen e këtij dokumenti, nga ana e zyrës noteriale do të kompletohet praktika, e cila nga shoqëria do të depozitohet në ZVRPP Tiranë, për të bërë kalimin e pronësisë në favor të blerësit.

Më datë 12.10.2016, mes palëve nënshkruhet kontrata përfundimtare, *kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol.*, në nenin 4 të së cilës është parashikuar çmimi i shitjes së apartamentit, në total prej 50.952 eurosh, ndërsa në nenin 5 përcaktohet se kjo *shumë është likuiduar totalisht*

¹³ Kjo kontratë është depozituar në ILDKPKI bashkëlidhur procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 22.02.2013, si dhe bashkëlidhur me deklaratën e pasurisë “*vetting*”.

sipas dokumenteve bashkëngjitur, ndërkohë që bashkëlidhur nuk gjendet i administruar asnjë dokument për likuidimin e çmimit. Ky apartament me numër pasurie {***}, zona kadastrale {***}, figuron i regjistruar në emër të Gjon M. Kodra, konfirmuar nga AShK, Drejtoria Vendore -Tirana Veri, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2020.

17.4. Për sa i përket mospërputhjes lidhur me pagesat e bëra për çmimin e apartamentit, ku në deklaratat periodike, subjekti i rivlerësimit deklaroi shlyerjen e pagesave të çmimit të blerjes në tri vite (në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006 deklaroi shlyer 35.952 euro, detyrimi i mbetur 15.000 euro; në vitin 2007 deklaroi shlyer 5.000 euro dhe mbetur detyrimi 10.000 euro; në vitin 2008 deklaroi shlyer 10.000 euro dhe mbetur 0 (zero) detyrim, *ndërsa* në kontratën format shitblerjeje, të cilësuar nga subjekti si kontratë sipërmarrjeje [viti 2006], përcaktohet se çmimi i blerjes prej 50.952 eurosh është *likuiduar plotësisht nga blerësi në favor të shitësit pa asnjë pretendim të mëtejshëm nga palët*, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pagesat për shlyerjen e çmimit prej 50.952 eurosh, janë bërë sipas deklarimeve në deklaratat e interesave privatë të viteve 2006, 2007 dhe 2008, në shumat prej 35.952 eurosh, 5.000 eurosh dhe 10.000 eurosh, përkatësisht. Përshkrimi në kontratën e shitblerjes se shuma e apartamentit prej 50.952 eurosh është likuiduar totalisht, sipas subjektit ka qenë element në formatin e kontratës tip dhe jo për të vërtetuar ose konfirmuar pagesën e kryer.

17.5. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të konstatimit të Komisionit se *subjekti nuk ka provuar me dokument ligjor shlyerjen e pagesave ndaj shoqërisë {***} ShPK për blerjen e apartamentit, sikurse dhe shoqëria {***} ShPK, nuk shprehet dhe nuk depoziton pranë Komisionit dokument në lidhje me pagesat, por konfirmon që subjekti nuk ka detyrime ndaj kësaj shoqërie*, me shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka depozituar 6 (gjashtë) mandatarkëtime të shoqërisë {***} ShPK, si vijojnë.

- Nr. {***}, datë 02.09.2006, arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 25.000 \$, “këst apartamenti ap. 4, kati 9, seksioni 2”.
- Nr. {***}, datë 16.12.2006, arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 5.000 euro.
- Nr. {***}, datë 16.12.2006, arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 5.000 \$.
- Nr. {***}, datë 20.12.2006, arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 8.000 euro, “pagesë apartamenti”.
- Nr. {***}, datë 11.07.2007, arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 5.000 euro, “këst për shtëpi”.
- Mandatarkëtimi pa numër, datë 15.12.2008, arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 10.000 euro.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se në deklaratën e interesave privatë 2006, është deklaruar shuma prej 35.952 eurosh, që përbën totalin e shumëve të paguar sipas mandateve të arkëtimit të vitit 2006 në monedhat euro dhe USD të këmbyerë [19.050 euro + 3.900 euro¹⁴ + 5.000 euro + 8.000 euro].

17.6. Në kushtet kur mënyra e pagesës së çmimit të apartamentit në kontratën e shitblerjes, të cilësuar kontratë sipërmarrjeje, të vitit 2006, është parashikuar ndryshe nga ajo e deklaruar në deklaratat periodike dhe sa ka rezultuar nga mandatarkëtimet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, edhe pse konstaton se këto mandate janë të diskutueshme për formatin e tyre, pasi rezultojnë pa vulën e shoqërisë {***} ShPK, dhe në disa raste nuk përmbajnë qëllimin e pagesës së kryer, në linjë me Komisionin dhe sa parashtruar nga Komisioneri Publik në ankim, kur shumat e likuiduara sipas mandatarkëtimeve në total korrespondojnë me detyrimet e shlyera shoqërisë sipërmarrëse të deklaruara në deklaratat e interesave privatë të viteve 2006, 2007 dhe 2008, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria ndërtimore nuk kujtojnë datat e sakta të shlyerjes së pagesave, analiza financiare e kryer nga Kolegji nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor është mbështetur në të dhënat e këtyre deklaratave periodike, të cilave ligji nr.

¹⁴ Vlera 25.000 USD [koeficienti i këmbimit të muajit dhjetor 2006, 1 USD/ 0,762 euro] = 19.050 euro; vlera 5.000 USD [koeficienti i këmbimit të muajit shtator, 1 USD/ 0,78 euro] = 3.900 euro.

84/2016, në nenin 32, pika 5 e tij, u ka dhënë cilësinë e provës. Kolegji u referohet, për efekt të verifikimit të mundësisë financiare, datave të pagesave sipas mandatarkëtimeve të sipërcituara, depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit në Komision.

17.7. Në analizë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, që përbëjnë dhe shkakun kryesor të ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, peshë domethënëse për këtë pasuri, nga analizimi i deklaratës së pasurisë 2003 dhe deklaratave të interesave privatë të viteve 2004 dhe 2005, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as të ardhura dhe as kursime në *cash* nga punësimi i bashkëshortes. Për herë të parë, të ardhurat e bashkëshortes dhe kursimet e saj në shumën 35.000 euro, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2006, që korrespondon dhe me vitin e blerjes së apartamentit objekt shqyrtimi. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhura nga bashkëshortja A. L. nga viti 1980 deri në vitin 1999, kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri (Shkodër) si përfaqësuese e firmave italiane, në shumën 35.000 euro. Nga kjo shumë, 30.000 euro janë deklaruar se kanë shërbyer për pagesën 35.952 euro në vitin 2006, ndërsa pjesa e mbetur prej 5.000 eurosh, sipas shpjegimeve të subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ka shërbyer për pagesën e kryer në vitin 2007, të deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti.

17.8. Lidhur me mungesën e deklaramit të kursimeve të bashkëshortes në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, dhe në deklaratat e interesave privatë për vitet 2004 e 2005, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet në Kolegj ka risjellë në vëmendje shpjegimet e dhëna prej tij në kuadër të procesit të rivlerësimit në Komision, duke argumentuar se këto kursime nuk janë deklaruar për disa arsye: i) ligji nr. 9049/2003, nga miratimi i tij deri në vitin 2017, ka ndryshuar disa herë, duke u përmirësuar, plotësuar dhe saktësuar deri në nivelin që është sot; ii) referuar neneve 21 dhe 22 të këtij ligji, në vitet 2003, 2004 dhe 2005, ka pasur paqartësi në lidhje me plotësimin e formularëve të deklaramit, fillimisht është kuptuar që subjekt deklarimi është vetëm zyrtari; iii) referuar deklaratës për herë të parë në vitin 2003, nuk rezulton ndonjë formular për deklaramin e personave të lidhur dhe në veçanti për persona që mbartin statusin *shtetas të huaj*; iv) në vlerësim të subjektit, formulari A-5, “Likuiditete”, ka qenë i paqartë pasi përshkrimi në kolonën “Vlefa në milionë/lekë ose valutë” është kuptuar prej tij si deklarim për gjendje likuiditeti në miliona valutë dhe se shuma e kursyer prej bashkëshortes, prej 35.000 eurosh, ishte shumë herë më e vogël. Subjekti ka pretenduar se nuk është instruktuar nga ILDKPKI-ja gjatë kontrolleve të kryera prej tyre, se gjendja e likuiditeteve mund të deklarohet edhe në mijë, pavarësisht përshkrimit në milionë; v) për herë të parë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, u përmendën pasuritë jashtë vendit; vi) znj. L. është shtetase italiane, legjislacioni dhe vetë ILDKPKI-ja e kishte të paqartë nëse duhej të deklaronte një shtetase e huaj, e cila në Itali zotëronte pasuri të përbashkët me prindërit (të trashëguar), zotëronte pasuri të luajtshme dhe likuiditet, të ardhura nga punësimi i saj nga viti 1980 e në vijim; vii) lidhja e martesës është kryer në Itali dhe jo në Shqipëri, për këtë arsye bashkëshortja nuk ka rezultuar në përbërjen familjare sipas legjislacionit në fuqi të kohës (në certifikatën e gjendjes civile në Shqipëri) dhe njëkohësisht pasuritë që ajo zotëron nuk rezultojnë të regjistruara në regjistrat publikë në Shqipëri, pra rrjedhimisht ajo nuk ka pasur detyrim për të deklaruar në deklaramet periodike 2004/2005).

Në arsyetim të sa pretenduar, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka qenë qëllim i tij fshehja apo mosdeklarimi i të ardhurave apo pasurive të bashkëshortes, por ka qenë *handikapi* ligjor dhe paqartësia në formularët e deklaramit, si dhe mungesa e këshillimeve nga ILDKPKI-ja, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, pasi në deklaratat e interesave privatë prej vitit 2009 e në vijim, ka deklaruar periodikisht të ardhurat e përfituara dhe pasuritë që zotëron bashkëshortja A. L. në Itali. Në momentin kur ka vendosur blerjen e apartamentit në Tiranë, subjekti shpjegon se ka deklaruar kontributin e bashkëshortes dhe burimin e shumës 35.000 euro në deklaramin e vitit 2006. Në vlerësim të subjektit të rivlerësimit, fakti që në deklaratën e personit që mbart

detyrimin për deklarim 2003 dhe në deklaratat e interesave privatë 2004 dhe 2005, përveç kursimeve nuk ka deklaruar as të ardhurat e përfituara nga punësimi/pensioni i bashkëshortes përbëjnë sipas tij një pasaktësi teknike, pasi subjekti i rivlerësimit pretendon se justifikon me burime të ligjshme financiare kursimet e bashkëshortes, provuar nga Komisioni në analizën e tij financiare e, për rrjedhojë, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit në linjë me Komisionin, pasaktësia në deklarim nuk është në masën që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit shprehet se Komisioneri Publik nuk kundërshton faktin se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë këtë shumë.

17.9. Trupi gjykues, nga analizimi i shkaqeve të ankimit, parashtrimeve dhe bisedimeve përfundimtare të Komisionerit Publik, konstaton se ato janë të fokusuara në aspektin ligjor të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të deklaruar kursimet në *cash* të bashkëshortes sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, si dhe të provuarit me dokumentacion të posedimit të këtij kursimi në kohën e përfitimit të apartamentit objekt shqyrtimi në vitin 2006. Nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se, referuar dokumentit “*Situazione di Famiglia Originaria*”, të lëshuar nga komuna e Ugentos, Itali, më 09.03.2021, përbërja familjare, sipas gjendjes civile në Itali, konsiston: Gjon Kodra, A. L. dhe Q. K.. Sipas certifikatës së banimit kronologjik, të lëshuar po nga komuna e Ugentos, Itali, prej datës 18.03.2002, subjekti i rivlerësimit rezulton me banim në adresën “{***}”, Itali. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. A. L. më datë 28.08.1999, në komunën Ugento, Lecce, Itali. Kjo martesë rezulton e regjistruar në dokumentin “Regjistër themeltar i shtetasve”, i arkivës digjitale të Gjendjes Civile, prej të cilit citohet: “Martuar me shtetase italiane më 28.08.1999, A. L.”. Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 05.02.2021, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. {***}, Bashkia Tiranë, shtetasi Gjon Kodra, banues në këtë njësi, ka lidhur martesë me shtetasen italiane A. L., në zyrën e gjendjes civile, Bari, Itali, me nr. akti martese {***}, datë 28.08.1999. Ky informacion, sipas vërtetimit, i referohet *Regjistrin themeltar “{***}” libri {***}, fleta {***}, ku është bërë zbatimi i kësaj martese*. Pra, në regjistrin e Gjendjes Civile në Shqipëri, statusi i subjektit të rivlerësimit figuron “i martuar”, por në certifikatën e përbërjes familjare nuk rezulton e regjistruar bashkëshortja A. L., e cila ka qëndruar në Shqipëri me leje qëndrimi¹⁵ të lëshuar nga Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë, depozituar nga subjekti i rivlerësimit me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

17.10. Gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja nga punësimi, për periudhën 1978 – 1999, përfshirë këtu dhe periudhën 8-vjeçare në Shqipëri si përfaqësuese e firmës italiane, subjekti i rivlerësimit ka depozituar “Estratto Conto Previdenziale”¹⁶, e Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore, të datës 17.10.2016, me të dhëna mbi pagat ose të ardhurat, “Retribuzione o Reddito”, për periudhën 01.02.1978 deri më 24.02.2003, si dhe “Dichiarazione di Prestazione Attivita’ Lavorativa” të datës 17.09.2018, lëshuar nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK [vula në këtë dokument i përket shoqërisë “{***}” ShPK], aktualisht me aktivitet të ndërprerë, i cili deklaroi se *A. L. ka qenë e punësuar pranë kësaj shoqërie nga viti 1992 deri në vitin 1999 në Shkodër, në pozicionin e kontrollorit të cilësisë pranë firmës “{***}” ShPK*. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni i drejtohet me kërkesë¹⁷ për informacion dhe dokumentacion shoqërisë “{***}” ShPK, mbi periudhën e punësimit të shtetasës A. L., funksionin e kryer pranë shoqërisë, të ardhurat neto të përfituara për secilin vit kalendarik,

¹⁵ - “Leje qëndrimi për të huajt” nr. {***} prot., datë 19.01.2008, për A. L., e vlefshme deri më datë 12.01.2009;
- “Leje qëndrimi për të huajt” nr. {***} prot., datë 19.02.2010, për A. L., e vlefshme deri më datë 10.01.2012;
- “Leje qëndrimi për të huajt” nr. {***} prot., datë 12.03.2012, për A. L., e vlefshme deri më datë 09.01.2014;
- “Leje qëndrimi për të huajt” Tipi C, “Qëllimi i qëndrimit – Bashkim Familjar”, “Gjendje Civile – e martuar”, e vlefshme nga data 15.06.2014 deri më 16.06.2024.

¹⁶ Ky dokument është dorëzuar me deklaratën e pasurisë “vetting”, më 20.01.2017.

¹⁷ Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.02.2021, të Komisionit, drejtuar shoqërisë “{***}” ShPK.

pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me pagat dhe dokumentacionin provues ligjor për kërkesat më sipër. Shoqëria “{***}” ShPK, nëpërmjet administratorit të saj, z. E. M., që rezulton të ketë qenë dhe administrator i shoqërisë italiane “{***}” ShPK më datë 19.02.2021, informon se: *L. A. nuk ka qenë kurrë e punësuar tek “{***}” ShPK, si pasojë nuk gjendet në librat kontabël. Prania e saj në kompani kishte funksionin ekskluzivisht të kontrollit të cilësisë nga klienti – {***} SRL, me seli në Itali, klient i yni. L. A. paguhej ekskluzivisht nga firma italiane. Ajo ishte përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së veshjeve të gatshme nga 1992 në 1999.*

17.11. Lidhur me pyetjen e ngritur nga Komisioni se ku ishte mbajtur nga bashkëshortja, shuma prej 35.000 eurosh (*cash*, në bankë në Itali, Shqipëri etj.), e deklaruar si kursim në deklaratën e interesave privatë 2006, si dhe nëse ishte mbajtur në Itali, si janë transferuar këto *para* në Shqipëri, në përgjigje të pyetësorit nr. 5 [datë 29.10.2021], subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se bashkëshortja i ka vënë në dispozicion *ekstrakte bankare*, në të cilat janë të pasqyruara të hyrat/të ardhurat e ligjshme dhe tërheqjet e bëra sipas përshkrimeve, dokumente të depozituara pranë Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar gjithashtu se nuk mund të paraqesë dokument tjetër ligjor që të vërtetojë se ku është mbajtur shuma prej 35.000 eurosh nga bashkëshortja, pasi dhe në kërkesat ligjore nuk përcaktohet ndonjë dokument për mënyrën e ruajtjes/mbajtjes së kursimeve në *cash*. Bashkëshortja, sipas subjektit të rivlerësimit, i ka pohuar se transferimi i parave të tërhequra nga llogaritë bankare në shtetin italian, është bërë në përputhje me kërkesat ligjore të shtetit italian dhe atij shqiptar, duke deklaruar se në asnjë rast, nuk është tejkaluar shuma [10.000 USD apo euro] për t’u deklaruar në pikat e kalimit kufitar, e përcaktuar në ligjet shqiptare¹⁸. Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit sqaron se nga sistemi TIMS, rezulton e provuar se për vitet 2005 dhe 2006, bashkëshortja e subjektit ka pasur 5 dalje/hyrje, ndërsa subjekti i rivlerësimit 2 dalje/hyrje, çka provon, sipas tij, mundësinë e sjelljes së valutës në vlerën 35.000 euro në Shqipëri, konform ligjeve shqiptare e të huaja.

17.12. Në analizë të situatës faktike të përmendur më sipër, pavarësisht faktit se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk rezulton në certifikatën e përbërjes familjare të tij, trupi gjykues vlerëson se përderisa subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar znj. A. L. si bashkëshorten e tij në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003 dhe në deklaratën periodike të vitit 2004, për pasojë duhej të deklaronte dhe të ardhurat dhe kursimet e saj ndër vite. Edhe pse bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk është shtetase shqiptare e nuk është natyralizuar¹⁹, në kuptim e zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë pasurinë, burimin e krijimit, të ardhurat dhe detyrimet financiare të saj, edhe nëse pasuria e pjesëtares së familjes ka qenë e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore. Neni 22 i këtij ligji përcakton dhe mënyrën e deklarimit, duke parashikuar se deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet, dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim. Paqartësitë e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, nuk mbështeten në dispozitat e sipërcituara të ligjit nr. 9049/2003, pasi këto dispozita nuk bëjnë dallim nëse bashkëshorti i subjektit deklarues është shtetas shqiptar apo i huaj. Në zbatim të nenit 4, germa “d”, nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në “Deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie”, dorëzuar më 26.03.2004, të gjitha pasuritë e akumuluar deri më 31 dhjetor 2003, të tij dhe bashkëshortes, përfshirë dhe likuiditetet.

¹⁸ Konkretisht ligjit nr. 8610, datë 17.05.2000, “Për parandalimin e pastrimit të parave”, neni 10, pika 1, dhe ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, neni 17/1, pika 1.

¹⁹ Neni 10 i ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar, parashikon: “I huaji që është i martuar me një shtetas shqiptar prej jo më pak se 3 vjetësh, në rast se dëshiron, mund të fitojë shtetësinë shqiptare me natyralizim edhe në qoftë se nuk plotëson kushtet e nenit 9, pikat 2 dhe 5. Në këtë rast, i huaji duhet të ketë banuar, në mënyrë të vazhdueshme dhe të ligjshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën një vit”.

17.13. Kolegji, në jurisprudencën e tij, ka trajtuar gjerësisht çështjen e deklaramit të likuiditetit në *cash* në deklaratat e interesave privatë, duke vlerësuar nën dritën e rrethanave konkrete dhe provave të administruara për çështjen. Në rastin objekt shqyrtimi, në kushtet e mosdeklarimit të kursimeve të bashkëshortes me burim nga të ardhurat e saj nga punësimi, në deklaratat e pasurisë dhe interesave privatë të viteve 2003, 2004 dhe 2005, ndonëse subjekti i rivlerësimit provoi teorikisht mundësinë e të ardhurave të krijuara nga bashkëshortja në vitet ‘80 dhe ‘90, në kushtet kur ekzistenca dhe gjendja e saktë e tyre nuk ka lënë gjurmë në asnjë formë, në deklaratat periodike, në llogaritë bankare apo në ndonjë dokumentacion tjetër ligjor që të tregonte dhe provonte mënyrën se si ato kanë mbërritur në Shqipëri apo janë ruajtur ndër vite, si dhe në konsideratë të harkut kohor të konsiderueshëm, nga momenti i fitimit deri në kohën kur deklarohet ekzistenca e tyre për herë të parë, përkatësisht nga vitet 1980-1999 në vitin 2006, trupi gjykues i Kolegjit e gjen pretendimin e Komisionerit Publik të bazuar. Për pasojë, këto të ardhura të pretenduara në vitin 2006, nuk u përfshinë në analizën financiare të Kolegjit. Si rrjedhojë e këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 4.021.882 lekë për kryerjen e pagesës prej 35.592 eurosh në vitin 2006, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. *Lidhur me pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2007*, Komisioneri Publik vlerëson se kjo shumë nuk mund të përfshihet në mesin e burimeve të ligjshme, për sa kohë nuk është deklaruar posedimi i saj në deklaratat periodike për vitet 2003 – 2005. Në vijim, as në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar burimin e krijimit dhe as pakësim të likuiditeteve *cash*. Shumat e tërhequra nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, prej 1.000 eurosh dhe 10.000 lekësh, deri në kohën kur është bërë kjo pagesë, më 11.07.2007, janë të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të periudhës dhe pagimin e shumës 5.000 euro. Komisioneri Publik, bazuar në orientimin e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2019, vlerëson se nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjekti i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë që një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë në deklaratat periodike. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë se nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2007, në shumën 5.000 euro.

19. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton:

19.1. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Paguar gjatë vitit 2007 shumën 5.000 euro, për apartamentin e pronotuar sipas deklaramit të mëparshëm. Detyrimi i mbetur, 10.000 euro.* Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume, ndërkohë që gjatë hetimit administrativ në Komision, me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, ka pretenduar se shuma prej 5.000 eurosh, e paguar në vitin 2007, është e ardhur nga kursimet e bashkëshortes nga punësimi për vitet 1980 - 1999, të deklaruara në deklaratën e interesave privatë 2006, në shumën prej 35.000 eurosh.

19.2. Në vijim të arsytimit në paragrafët 17.12 dhe 17.13 në këtë vendim, shuma prej 5.000 eurosh, e pretenduar me burim nga kursimet e bashkëshortes për periudhën 1980 – 1999, nuk u përfshi në analizën financiare të kryer në Kolegji. Rezultatet e analizës ekonomiko-financiare për të provuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, për periudhën 01.01.2007 deri më 11.07.2007, për të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme shumën 5.000 euro, të deklaruar si pagesë për shlyerjen e çmimit të apartamentit, sipas mandatarkëtimit nr. {***}, datë 11.07.2007, “arkëtuar nga Gjon Kodra, shuma 5.000 euro, këst për shtëpi”, të depozituar nga subjekti me shpjegimet e rezultatit të hetimit administrativ, treguan se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare në vlerën (-) 599.961 lekë, për të mbuluar pagesën prej 5.000 eurosh, për likuidimin e detyrimit ndaj shoqërisë {***} ShPK, më datë

11.07.2007. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. *Lidhur me pagesën e shumës 10.000 euro në vitin 2008*, Komisioneri Publik ka ngritur pretendimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të pagesës prej 10.000 eurosh në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e kryer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 129 m², në vitin 2008, shpenzimet dhe kursimet e vitit, për një diferencë negative në shumën (-) 563.752 lekë.

21. Në analizë të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues konstaton:

21.1. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Paguar gjatë vitit 2008, shuma 10.000 euro për apartamentin e prenotuar në vitin 2006, me shoqërinë {***} ShPK, në adresën: rr. “{***}”, pallati {***}, Tiranë. Detyrimi i mbetur, zero.* Në këtë deklaratë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume.

21.2. Komisioni, në analizën financiare për vitin 2008, ka dalë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative në vlerën (-) 563.752 lekë. Këtë mungesë, së bashku me pamjaftueshmërinë e rezultuar në vitin 2011, në vlerën (-) 344.411 lekë, Komisioni, bazuar në parimin e proporcionalitetit, e ka vlerësuar të pamjaftueshme për të aplikuar masën e disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

21.3. Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, për periudhën 01.01 deri më 15.12.2008, për likuidimin e pagesës 10.000 euro, sipas mandatarkëtimit. Duke qenë se analiza financiare tregoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 530.999 lekë, trupi gjykues çmon se subjekti ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për likuidimin e pagesës 10.000 euro.

22. Në përfundim të gjithë sa arsyetuar më sipër në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 129 m², ndodhur në {***}, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë duke mos deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimin e krijimit të kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me kursimet në *cash* në shumën 35.000 euro, me burim të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes për periudhën 1980 – 1999, në kushtet e mosdeklarimit të tyre në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklaram pasurie, dorëzuar më datë 26.03.2004, dhe në deklaratat e interesave privatë të viteve 2004 dhe 2005, si dhe mosprovimi i posedimit të tyre në kohën e blerjes së apartamentit në vitin 2006, çon në konkluzionin se këto kursime nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Me këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme edhe për pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2007. Në të njëjtën situatë të pamjaftueshmërisë financiare, subjekti i rivlerësimit rezultoi dhe për likuidimin e pagesës 10.000 euro në vitin 2008. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, deklaram të pamjaftueshëm në zbatim të nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

C. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për ekzistencën e konfliktit të interesit

23. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, Komisioneri Publik ka ngritur disa pretendime: i. përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm, duke vlerësuar se marrëdhënia e interesit [detyrimet e ndërsjella juridiko-civile] ndërmjet subjektit dhe shtetasit A. A. nuk kishte përfunduar në vitin 2008, por ka vazhduar në vitin 2010 e më tej në vitin 2016, me finalizimin e kontratës së shitblerjes; ii. arsyetimi i Komisionit nuk duhet të qëndrojë vetëm në kufijtë e konstatimit të një trajtimi preferencial, qoftë edhe ai me përfitime të dyanshme mes palëve, pasi trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit, por mund të ekzistojë edhe pa provuar atë situatë. Arsyetimi i Komisionit se nuk u provua trajtimi preferencial në çmimin e apartamentit apo se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në pushimin e çështjes penale ku iniciues ishte shtetasi A. A., u gjet i drejtë nga gjykata, duke treguar kështu se subjekti i rivlerësimit ka garantuar paanësinë e tij, nuk është përcaktuese, nëse ky përfundim nuk mbështetet në vlerësim tërësor të provave; iii. me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit apo atij në dukje, subjekti i rivlerësimit duhej të hiqte dorë nga hetimi i procedimit penal nr. {***}, datë 24.06.2010, jo thjesht duke vënë në dijeni drejtuesin e sektorit, sikundër ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, pa paraqitur asnjë akt provues, për të cilin vlen të përmendet praktika e Kolegjit në raste të ngjashme [vendimi JR nr. 10/2021, paragrafi 45]; iv) subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e heqjes dorë, me qëllim shmangien e çdo dyshimi për paanësinë e tij, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, që çon në një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë, sipas përcaktimeve të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, dhe nga një vlerësim tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, trupi gjykues konstaton:

23.1. Komisioni, në vendim, ka vlerësuar se pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka trajtuar një çështje ku palë ka qenë një person me të cilin ka pasur një marrëdhënie juridiko-civile, e cila në sytë e një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, mund të vërë në diskutim paanësinë e subjektit në vendimmarrje, situatë për të cilën subjekti duhet të kishte treguar fillimisht kujdes të shtuar, ai ka kaluar me sukses testin objektiv dhe atë subjektiv, duke qenë i besueshëm dhe bindës në garantimin e parimit të paanësisë dhe të parimit se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se jepet. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se indikatorët e integritetit dhe të paanësisë arrijnë një nivel të konsiderueshëm në favor të subjektit të rivlerësimit, deri në atë masë sa ai nuk mund të penalizohet me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për cenim të besimit të publikut, në zbatim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

23.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se Komisioni gjatë hetimit administrativ mbi kriterin e pasurisë, në kuadër të identifikimit të ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me personat me të cilët ka pasur marrëdhënie kontraktuale, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka trajtuar kallëzime/procedime penale të iniciuara prej ose ndaj tyre. Më konkretisht, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 23.04.2021, Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje me procedime penale, kërkesa për gjykim, vendime mosfillimi dhe vendime pushimi për periudhën 08.10.1997 e në vijim për disa subjekte, përfshirë dhe shoqërinë {***} ShPK dhe administratorin e saj, z. A.F.A..

23.3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2021, informon se nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikat elektronike të procedimeve penale për periudhën kohore 1997 – 2021, rezulton se për subjektin A.F.A., të jenë regjistruar disa kallëzime dhe procedime penale, në të cilat ky shtetas ka qenë i kallëzuar apo kallëzues. Ndër to dhe procedimi penal nr. {***} i vitit 2010, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me kallëzues A. A., administrator i shoqërisë

{***} ShPK, ndaj punonjësve të OSSh-së për faturime afrofe, duke ngarkuar pa të drejtë shlyerjen e detyrimit nga shoqëria. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të kësaj çështjeje, vendosi pushimin e procedimit penal, duke arsyetuar se pavarësisht se kallëzuesi ka të drejtë në pretendimin e tij, veprimet e punonjësve të OSSh-së nuk janë kryer në kundërshtim me ligjin, dhe në veprimet apo mosveprimet e tyre nuk konstatohen elemente të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Mosmarrëveshja duhet të zgjidhet me marrëveshje të palëve ose pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të karakterit juridiko-civil.

23.4. Nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se kallëzuesi A. A. ka ushtruar mjetin procedural të ankimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër vendimit të pushimit të procedimit penal, me objekt: “Kundërshtimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës, argumentohet se organi i akuzës ka konstatuar me të drejtë se mosmarrëveshjet e krijuara janë të karakterit juridiko-civil dhe, si të tilla, duhet të zgjidhen nga gjykata civile. Gjykata në këtë vendim ka vlerësuar se hetimi i kësaj çështjeje ka qenë i plotë dhe se nuk është e nevojshme marrja e asnjë prove tjetër lidhur me vërtetimin e fakteve objekt hetimi. Gjykata ka vlerësuar gjithashtu se nuk mund të marrë rol aktiv dhe të urdhërojë ndjekjen penale duke prishur vendimin e pushimit të prokurorisë, përderisa nuk ka asnjë rrethanë që duhet verifikuar apo provë të marrë me rëndësi për çështjen. Sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, në rastin konkret, një analizë të tillë mund ta bëjë prokurori më i lartë, i cili ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të prokurorit më të ulët, pa e lidhur këtë të drejtë me kryerjen e hetimeve apo arritjen e një konkluzioni të ndryshëm nga ai i prokurorit më të ulët. Në përfundim, me vendimin nr. {***}, datë 11.07.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi rrëzimin e kërkesës së kërkuarit A. A., si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim nuk u ankimua dhe mori formë të prerë më datë 21.07.2011.

23.5. Në kuptim të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysht këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”, etika në lidhje me situatën e konfliktit të interesit është përfshirë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 40 dhe 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procedura e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit bëhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, indikator i etikës dhe paanësisë vlerësohet dhe në lidhje me kujdesin e magjistratit ndaj konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

23.6. Trupi gjykues i Kolegjit, për të konkluduar nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, në procedimin penal nr. {***}, të vitit 2010, iu referua dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), konkretisht nenit 3, pika 1²⁰ dhe nenit 5, pika 1²¹ e tij,

²⁰ Neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, parashikon: “Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike”.

²¹ “Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit

në të cilat përkufizohet konflikti i interesit dhe përcaktohet ana përmbajtësore e rrethit të interesave privatë, si dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në të cilat parashikohen kushtet dhe procedurat që duhen ndjekur nga gjyqtarët dhe prokurorët për të shmangur situatën e konfliktit të interesit. Ndër rrethanat që mund të dëshmojnë konfliktin e interesit, janë dhe të drejtat dhe detyrimet pasurore të çdo lloji natyre, çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile, si dhe marrëdhëniet e njohura të miqësisë [neni 5, pika 1, përkatësisht gërmat “a”, “b” dhe “dh”, nënpika “v” e ligjit nr. 9367/2005].

23.7. Nga analizimi i kontratave të nënshkruara mes subjektit të rivlerësimit dhe administratorit të shoqërisë {***} ShPK, z. A. A., rezulton se në kohën e regjistrimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2010, dhe kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, mes tij dhe z. A. ishte nënshkruar *kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, apartament, e vitit 2006*, trajtuar në nënparagrafët 17.3, 17.4 dhe 17.6 të këtij vendimi. Pavarësisht faktit se në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar shlyerjen tashmë të pagesave të çmimit të apartamentit prej 50.952 eurosh, përsëri nuk ishte nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2016, si dhe palët nuk kishin konkluduar mbi detyrimet që mund të rezultonin pasi apartamenti të dorëzohej, ashtu siç në fakt rezultoi më pas me nënshkrimin e aktmarrëveshjes, datë 22.02.2017, me të cilën palët u dakordësuan që nuk kishin më detyrime financiare ndaj njëra-tjetrës. Në vitin 2010, kur është regjistruar procedimi penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë kryer punime në këtë apartament, ashtu siç deklaroi në përgjigjet e pyetësorit nr. 4 [administruar me nr. {***} prot., datë 08.10.2021], se pagesat për punimet e kryera në apartament janë bërë gjatë vitit 2010, dhe se në kohën e firmosjes së kontratës përfundimtare së shitjes, nuk ishin finalizuar ende detyrimet e ndërsjella me administratorin e shoqërisë {***} ShPK, pra detyrimi i shoqërisë ndërtuese ndaj subjektit të rivlerësimit për punimet e kryera në shumën prej 4.850 eurosh dhe vlera korresponduese për sipërfaqen shtesë prej 11 m², në vlerën 4.752 euro. Për këtë shkak, sipas subjektit të rivlerësimit, me aktmarrëveshjen e datës 22.02.2017, u formalizuan detyrimet e ndërsjella. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk ishte finalizuar kjo marrëdhënie me karakter pasuror përmes nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes në vitin 2016 dhe aktmarrëveshjes në vitin 2017, trupi gjykues gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik se marrëdhënia e interesit ndërmjet subjektit dhe shtetasit A. A. nuk kishte përfunduar në vitin 2008, ashtu siç është përcaktuar nga Komisioni në vendim.

23.8. Përveç marrëdhënies juridiko-civile për shkak të *kontratës për shitblerje pasurie të paluajtshme, apartament, të vitit 2006*, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision dhe parashtrimeve në Kolegj, është shprehur se me shtetasin A. A., ka lidhje shoqërore dhe familjare që prej vitit 2005, kanë udhëtuar disa herë bashkë jashtë Shqipërisë pasi janë fqinjë, kanë krijuar lidhje shoqërore e familjare dhe prej vitesh subjekti i rivlerësimit frekuenton ambientet e bar-kafes në pronësi të shtetasit A. A., që ndodhet në katin e parë të godinës ku banon. Subjekti deklaroi se me këtë shtetas ka pasur vetëm marrëdhënie shoqërore në vazhdimësi dhe jo marrëdhënie interesi të ndërsjellë që të kenë cenuar apo të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësisë të tij publike. Ky fakt, sipas subjektit, vërtetohet me vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2010, në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri e përgjegjësi në mbrojtje të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar dhe marrëdhënien e miqësisë me shtetasin A. A., trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “dh/v” të ligjit nr. 9367/2005, të interesit privat për shkak

apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtari që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë.”

të interesit pasuror, marrëdhënies juridiko-civile, si dhe marrëdhënies së njohur të miqësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale, që parashikon heqjen dorë nga çështja *kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie*, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja në zbatim të nenit 26 të këtij kodi, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

23.9. Gjithashtu, sa i përket arsyetimit të Komisionit në vendim, *se nuk u provua se kishte një trajtim preferencial që mund të konsistonte në aplikimin e një çmimi të ulët të favorshëm nga shoqëria {***} ShPK në favor të subjektit, përkundrazi subjekti me kontratat e ngjashme të vëna në dispozicion të Komisionit, provoi bindshëm se çmimi i paguar prej tij ishte real, shumë i përafërt me atë të pasqyruar në kontratat e ngjashme dhe jofavorizues për subjektin*, trupi gjykues konsideron të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik në ankim, se shqyrtimi i këtij rasti nuk qëndron vetëm në kufijtë e konstatimit të një trajtimi preferencial, qoftë ai me përfitime të dyanshme mes palëve, pasi trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit dhe mund të ekzistojë edhe pa provuar atë gjendje.

23.10. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, dhënë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, se me marrjen e kallëzimit penal, ka kontaktuar me drejtuesin e seksionit të cilin e ka vënë në dijeni të marrëdhënies që ka pasur dhe ka me shtetasin A. A. dhe se drejtuesi, sipas subjektit, ka çmuar se subjekti duhej të kryente veprimet hetimore dhe nëse, nga këto veprime, do të konkludonin në përgjegjësinë penale të punonjësve të OSSh-së, do të procedohej me dorëheqje, Komisioni në vendim është shprehur se *pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka treguar kujdesin e duhur duke njoftuar drejtuesin e tij, lidhur me marrëdhënien e miqësisë me kallëzuesit, mbetet në kuadër deklarativ dhe i paprovuar*.

Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës gjyqësore publike të datës 04.07.2022 në Kolegj, ka kërkuar riçeljen e pjeshme të hetimit dhe pranimin e depozitimit të provave shpresore të dërguara së bashku me parashtrimet e datës 28.06.2022, të cilat konsistojnë në: *i. deklaratën e z. E. M., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vërtetim nënshkrimi noterial nr. {***} rep., datë 22.06.2022; ii. urdhrin nr. {***}, datë 11.10.2010, “Për organizimin e prokurorëve dhe opjive”.*

Nga analizimi i këtyre akteve shpresore të administruara me vendim të ndërmjetëm, në cilësinë e provës, trupi gjykues konstaton se në urdhrin nr. {***}, datë 11.10.2010, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit rezultoi prokuror në *Seksionin kundër vjedhjeve me dhunë e armë, Komisaritet e Policisë Nr. {***} dhe {***}*, drejtuar nga zëvendësdrejtues E. M. [aktualisht prokuror pranë kësaj prokurorie]. Ky i fundit, më datë 13.06.2022, ka bërë deklaratën, duke u shprehur se në vitet 2008 – 2012, ka qenë zëvendësdrejtues i prokurorisë dhe drejtues i seksionit, dhe kallëzimi i paraqitur nga shtetasi A. A. i ishte caktuar prej tij prokurorit Gjon Kodra. Sipas deklarimit të z. M., prokurori i çështjes, me marrjen e materialit kallëzues në sekretarinë e prokurorisë, i ka parashtruar që kallëzuesin e kishte të njohur, si dhe i ka treguar që me të *marrëdhëniet ishin sa të natyrës shoqërore, aq dhe të natyrës financiare*, pasi mes tyre ishte lidhur një kontratë për blerjen e një apartamenti në një objekt në ndërtim nga z. A. A.. Kallëzuesi, sipas deklaruesit, ishte i njohur edhe prej tij, pasi kishte shumë kallëzime në prokurori. Sipas deklaruesit E. M., subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar që çështja t’i lihej një prokurori tjetër, ndërsa z. M., pasi ishte njohur me materialin kallëzues që ishte në fillimet e hetimit, kishte vendosur që hetimi të kryhej nga një oficer i policisë gjyqësore pa u ndikuar dhe, në përfundim, do të rishihnin gjendjen e akteve dhe nëse do të kishte vend për të riparë kërkesën e prokurorit. Prokurori Gjon Kodra ka vendosur pushimin e hetimeve dhe z. M. deklaroi se e ka miratuar atë. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi këto dy prova, vlerësoi se si parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, ashtu dhe përmbajtja e deklaratës së z. E. M. nuk provuan që një kërkesë e tillë për heqje dorë e subjektit të rivlerësimit nga procedimi penal me kallëzues z. A. A., është paraqitur realisht. Në kushtet kur deklarata personale e z. M. jo vetëm nuk përbën akt zyrtar, por as nuk arrin të zëvendësojë mungesën e akteve të hartuara në formën e duhur dhe në kohën kur ka

ndodhur ngjarja, trupi gjykues, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka treguar kujdesin e duhur duke njoftuar drejtuesin lidhur me marrëdhënien e miqësisë me kallëzuesin, e gjen deklarativ dhe të paprovuar.

23.11. Fakti që subjekti i rivlerësimit, në përfundim të hetimeve, ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal, i cili më pas u gjet i drejtë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që me vendimin nr. {***}, datë 11.07.2011, vendosi rrëzimin e kërkesës së kërkesit A. A. me objekt: “Kundërshtimin e vendimit për pushimin e çështjes penale nr. {***}, të vitit 2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, si të pabazuar në prova dhe në ligj, nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor që ka pasur për heqjen dorë nga hetimi i kësaj çështjeje penale.

23.12. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë konceptin e paanësisë [përcaktuar si vlera nr. 2 dhe nënpjesët e saj] sipas Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, të cilat zbatohen edhe për prokurorët. Paanësia është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që e paraprin atë. Perceptimi i mungesës së paanësisë cenon besimin e publikut te drejtësia²². Testi i zbatuar rregullisht është nëse një vëzhgues i arsyeshëm, i cili e sheh çështjen në mënyrë reale dhe praktike, do të (ose “mund të”) perceptonte një mungesë paanësie nga gjyqtari²³, qoftë dhe për shkak të konfliktit të interesit. Prokurori duhet të japë dorëheqjen nga pjesëmarrja në një procedim në të cilin një vëzhguesi të arsyeshëm mund t’i duket se prokurori e ka të pamundur të vendosë me paanësi [vlera 2, pika 2.5].

23.13. Në mbështetje të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar që me veprimet e tij, të shmangë dyshimin për paanësinë e tij, duke mos paraqitur dorëheqjen nga hetimi i procedimit penal nr. {***} të vitit 2010, me kallëzues shtetasin A. A., bazuar në nenin 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale, që parashikon heqjen dorë nga çështja *kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie*, duke afektuar kështu indikatorin e parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016²⁴, sa i përket *kujdesit ndaj konfliktit të interesit*. Në kushtet kur nuk janë evidentuar raste të tjera, ekzistenca e konfliktit të interesit në këtë rast, si një rast i vetëm, me konsideratë rrethanat e çështjes, nuk do të ishte e mjaftueshme për të afektuar kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit dhe, për këtë arsye, problematika e hasur është trajtuar në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes.

D. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kontrollin e figurës

- 24.** Komisioneri Publik, bazuar në rekomandimin e ONM-së, përmbajtjen e *gjetjes* së vëzhguesit ndërkombëtar, e cila, referuar dispozitës së nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, përbën provë të barasvlershme me mendimin e një eksperti, duke e bërë këtë *gjetje* pjesë të shkaqeve të ankimit, lidhur me kontaktin e subjektit të rivlerësimit me shtetasin P. A., person i përfshirë në krimin e organizuar, çmon se përfundimi i Komisionit lidhur me kontrollin e figurës, nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Në analizë të këtij shkakut ankimor, trupi gjykues konstaton:

24.1. Komisioni në vendim ka arsyetuar se, pavarësisht se shtetasi P. A. rezulton të ketë qenë person i përfshirë në krimin e organizuar, nuk provohet në mënyrë të pakundërshtueshme që ky

²² Paragrafi 55 i Komentarit mbi Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore:

https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principle_of_Judicial_Conduct.pdf.

²³ Paragrafi 56 i materialit të sipërcituar.

²⁴ Neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon: “Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë, si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi”.

person të ketë qenë një kontakt i papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit. Ekzistenca e një telefonate të vetme në vitin 2008 nga shtetasi P. A., kur nuk disponohej informacion që të ishte përfshirë në veprimtarinë e trafikut ndërkombëtar të drogës, si dhe padijenja e subjektit të rivlerësimit mbi situatën ligjore të tij, nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi për pasje kontakti të papërshtatshëm dhe mosdeklarim të tij në deklaratën e kontrollit të figurës. Në vlerësim të Komisionit, telefonata e vetme, pavarësisht përmbajtjes, nuk mund të arrijë një shkallë thelbësore dhe përcaktuese në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e figurës apo vlerësimin tërësor të tij në kuadër të cenimit të besimit të publikut, deri në atë masë sa ndaj të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Për kriterin e kontrollit të figurës, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, dhe konfirmon kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.

24.2. Nga analizimi i akteve të dosjes, trupi gjykues konstaton se DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht²⁵, ka konstatuar *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gjon M. Kodra*. Në vijim të kërkesës²⁶ së Komisionit për përditësim të raportit duke përfshirë informacionin e dërguar nga Shërbimi Informativ Shtetëror dhe deklasifikimin e tij, DSIK-ja përcjell raportin me nr. {***} prot., datë 19.10.2021, të deklasifikuar pjesërisht²⁷. Referuar këtij raporti, nga informacionet e ardhura nga organi verifikues, në kohështrirje përpara periudhës së rivlerësimit, *subjekti i rivlerësimit, në vitin 2008 ka pasur një kontakt të papërshtatshëm/jorastësor me një person të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike, ku dyshohet se z. Kodra mund të jetë përfshirë edhe vetë në këtë aktivitet*. Në vijim, në këtë raport, citohet se brenda periudhës së rivlerësimit, nga viti 2017 e deri aktualisht, në lidhje me subjektin e rivlerësimit nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme. Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, rezulton se bazuar në nenin Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, veprimtaria e dyshuar si kontakt i papërshtatshëm, i përket para periudhës së rivlerësimit, 01.01.2012, fakt ky që mund të konsiderohet rrethanë lehtësuese, sipas përcaktimeve dhe kritereve të përcaktuara në germën “d” të pikës 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, pasi veprimtaria e dyshuar e kundërligjshme e subjektit të rivlerësimit, i përket një periudhe shumë të hershme kohore dhe nuk ka tregues apo të dhëna që të evidentojnë faktin që ajo vazhdon. Raporti përfundon duke konkluduar se, *në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Gjon M. Kodra, gjykojmë që për rastin në fjalë, konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit*.

24.3. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga organet ligjzbatuese, rezulton se më datë 19.01.2008, është realizuar një bisedë telefonike ndërmjet numrit të telefonit në emër të një individi, z. P. A.²⁸, dhe numrit të telefonit në emër të z. Gjon Kodra. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni, për të verifikuar këtë kontakt të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, ka kërkuar informacion pranë shoqërive telefonike për të provuar nëse numrat e

²⁵ Me vendimin nr. {***}, datë 09.07.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

²⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 05.10.2021, e Komisionit, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për përditësimin dhe deklasifikimin e raportit nr. {***} prot., datë 02.11.2017”.

²⁷ Me vendimin nr. {***}, datë 20.10.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret”.

²⁸ Referuar informacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, rezulton që ky shtetas të ketë ndërruar jetë më 02.05.2011.

telefonit [përkatësisht numrat {***} dhe {***}] i përkisnin subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit P. A.. Në të njëjtën kohë, i është drejtuar për informacion Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me procedimet dhe vendimet penale ndaj këtij shtetasi. Në kuadër të këtij hetimi, ka rezultuar:

24.3.1. Nga informacioni²⁹ i vënë në dispozicion nga shoqëria “{***}” ShA, në periudhën kur është realizuar biseda telefonike, këta numra ishin në përdorim përkatësisht të shtetasit P. A. dhe subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.

24.3.2. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 14.10.2021, informon se më datë 11.10.2007, është regjistruar procedimi penal me nr. {***}, në ngarkim të shtetasit P. I. A., i datëlindjes 25.10.1966, për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a dhe 333 të Kodit Penal dhe, në përfundim të hetimeve, më datë 01.09.2009, është vendosur pushimi i procedimit.

Në vendimin “Për pushimin e çështjes në ngarkim të të hetuarit P. A.”, të prokurorëve të çështjes A. Xh. dhe B. D., citohet se procedimi penal ka filluar në bazë të akteve të transmetuara nga Prokuroria Antimafia e Milanos, Itali. Nga aktet e administruara dhe konkretisht, nga përgjimet telefonike të subjekteve të përfshira në trafikun e lëndëve narkotike, janë sekuestruar disa dërgesa të lëndës narkotike, si dhe janë kryer arrestimet përkatëse të korrierëve. Në vendimin e pushimit, arsyetohet se në interes të hetimeve të kryera rreth këtij procedimi, si dhe me qëllim grumbullimin e të dhënave të nevojshme lidhur me vërtetimin e akuzës në ngarkim të shtetasit P. A., identifikimin e plotë të bashkëpunëtorëve të tij, si dhe individualizimin e përgjegjësive penale të tyre, ndër të tjera, më datë 08.11.2007, u është dërguar letërporosi autoriteteve gjyqësore italiane, lidhur me faktet kriminale të konsumuara nga i hetuari P. A.. Në kushtet kur autoritetet gjyqësore italiane nuk i kishin kthyer përgjigje letërporosisë së dërguar, pavarësisht kujtesave të shumta, meqenëse nga hetimet e kryera, nuk u arrit të provohet pjesëmarrja e të hetuarit P. A. në kryerjen e veprave penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike” dhe “Organizatës kriminale”, të parashikuara nga nenet 283/a dhe 333 të Kodit Penal, si dhe në veprimet e personit nën hetim nuk u konstatuan elemente të ndonjë veprave tjetër penale, u procedua me pushimin e hetimit të këtij procedimi.

24.3.3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.10.2021, informon se për këtë shtetas nuk rezulton të ketë vendime penale.

24.3.4. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit depoziton shkresën nr. {***} prot., datë 23.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila informon se nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikat elektronike të procedimeve penale për periudhën kohore 1997 – 2021, nuk rezulton që prokurori Gjon Kodra të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me shtetasin P. A.. Kjo prokurori, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.11.2021, drejtuar Komisionit, informon se për këtë periudhë, ndaj shtetasit P. I. A., rezultojnë disa procedime penale³⁰. Në një nga këto

²⁹ Me shkresat nr. {***} prot., datë 12.10.2021 dhe nr. {***} prot., datë 20.10.2021.

³⁰ Procedimet penale ndaj shtetasit P. I. A.: i. procedimi penal nr. {***} i vitit 2006, për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, pushuar më datë 03.08.2006; ii. procedimi penal nr. {***} i vitit 2006, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 89/25 i Kodit Penal, pushuar më datë 05.09.2006; iii. procedimi penal nr. {***} i vitit 2007, për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, pushuar më datë 03.03.2008; iv. procedimi penal nr. {***} i vitit 2009, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, pushuar akuza për P. A. më datë 07.12.2010; v. procedimi penal nr. {***} i vitit 2014, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, pezulluar më datë 05.03.2015, dhe dosja është dërguar për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë.

procedime, atë nr. {***} të vitit 2000, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me prokurorë të çështjes A. Th. dhe A. Ç., prokurori A. Th., më datë 08.02.2001, ka dërguar për gjykim këtë procedim penal. Komisioni, nga analizimi i fashikullit të prokurorisë, konstatoi se dokumenti “Konkluzione mbi procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të të pandehurit P. A.”, i mbajtur gjatë seancës gjyqësore, ishte nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra. Në këto konkluzione, subjekti i rivlerësimit shprehej se: *I pandehuri P. A. si në hetim, dhe në gjykim ka pranuar akuzën dhe ka mbajtur qëndrim pendues ndaj çka u shpreh dhe në kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila u pranua nga gjykata si e drejtë. Në kërkesën tonë për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, do të mbajmë parasysh kërkesat e nenit 48, germa “ç” e Kodit Penal, si dhe rrethana të tjera. [...] i paraqes gjykatës këtë kërkesë: Deklarimin fajtor të pandehurit P. A. për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit, duke pasur parasysh dhe kërkesën e nenit 406 të K.Pr.Penale.*

24.3.5. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni në vendim e ka konsideruar formal depozitimin e konkluzioneve në gjykatë me firmën e subjektit të rivlerësimit, me kërkesën për dënimin me burg të shtetasit P. A., po kështu fakti që kjo çështje është filluar në vitin 2000 dhe ka përfunduar në vitin 2001, shumë kohë më parë telefonatës së datës 19.01.2008, përveç ushtrimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk vërteton asnjë indicie, fakt apo provë që të vërtetojë njohjen personale të subjektit të rivlerësimit me shtetasin P.A., dhe aq më tepër kontakte apo lidhje të ngushtë mes tyre dhe në vazhdimësi.

24.4. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit më datë 08.11.2021, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., i ka drejtuar Komisionit një *gjetje* për subjektin e rivlerësimit. Në këtë gjetje, ONM-ja i referohet jurisprudencës³¹ së Kolegjit, sa i përket kontrollit të figurës, i cili bazohet në dy elemente komplementare të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit. Lidhur me elementin përmbajtësor të kontrollit të figurës, në kuptim të nenit 38, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012. Për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra duhet të zbatohen standardet ligjore, ai nuk mund të jetë përgjegjës sipas “elementit formal” të vlerësimit të figurës për një deklaram të pamjaftueshëm eventual nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme në kushtet e ligjit nr. 84/2016, para vitit 2012, por në “elementin përmbajtësor”, subjekti mund të vlerësohet përgjegjës për kontaktet e mundshme të papërshtatshme që mund të kenë ndodhur më herët, megjithëse afati kohor i mëparshëm i këtyre kontakteve duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, në përputhje me nenin 38, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

Në këtë *gjetje*, referohet mbi faktin se vëzhguesi ndërkombëtar disponon dokumentacion të lëshuar nga organet e shtetit italian, sipas të cilit një person P.A., i lindur më 25.10.1966, është dënuar me vendim të formës së prerë me 18 vite burgim (në vitin 2011) për veprat penale “Trafikim të lëndëve narkotike” dhe “Krim të organizuar” në Itali. Personi, sipas referimeve në gjetje, përfitonte gjithmonë në Itali të ashtuquajturën *indulto*, një masë amnistie që mund të ulë dënimin, por nuk eliminon përgjegjësinë penale. Si pasojë, rezulton se dënimi i formës së prerë për këto vepra penale, është ulur përfundimisht në 2 vjet e 6 muaj burgim dhe si masë sigurie, personi është deportuar nga shteti italian.

24.5. Me *gjetjen*, vëzhguesi ndërkombëtar depoziton edhe dokumente që i janë vënë në dispozicion nga shteti italian, përfshirë dhe certifikatë numër{***}, datë 21.10.2021, lëshuar nga Sistemi Informativ i Dëshmimeve [Ministria e Drejtësisë], Certifikatë Penale e Dëshmisë së Penalitetit për shtetasin P. A., për të cilin rezultojnë vendimet:

- 03.05.2011, vendim i Gjykatës së Apelit Milano me formë të prerë, datë 03.11.2011. Lënie në

³¹ Shih vendimin nr. 30, datë 18.11.2019, paragrafët 55 dhe 56 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

fuqi e vendimit të lëshuar më datë 22.06.2010 nga Gjykata e Milanos, për veprat penale “Trafik i paligjshëm i lëndëve narkotike në bashkëpunim” dhe “Themelim, drejtim ose financim i organizatës kriminale në trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike”, të kryera gjatë vitit 2006 në Shqipëri dhe në Itali. Referuar dispozitivit, është vendosur heqje lirie 18 vite, dhe si dënime plotësuese, përjashtim i përjetshëm nga detyrat publike; përjashtim ligjor për të gjithë kohëzgjatjen e dënimit. Masat e sigurisë: Përjashtim i të huajit nga shteti.

- 27.06.2012, me vendim të Gjykatës së Milanos me një gjyqtar të vetëm, aplikohet falja sipas L.31.07.2006, nr. 241. Dënimi kryesor i falur: Heqje lirie 2 vite e 6 muaj.

24.6. Për sa i përket njohjes me shtetasin P. A., i pyetur³² nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit është shprehur se këtë shtetas e ka njohur si vëllain e ish-deputetit S. A., por nuk ka pasur lidhje shoqërore apo familjare, nuk ka udhëtuar dhe nuk ka qëndruar asnjëherë me të në ndonjë ambient si bar-kafe apo vende të tjera. Në kujtesën e tij, nuk ka komunikuar ndonjëherë në telefon dhe nuk ka pasur kontakte apo biseda që lidhen me detyrën të cilën kryen. Pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, se ku e kishte gjetur shtetasi P. A. numrin e telefonit të tij, në seancën dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se numri i tij është publik, e zotëronte prej vitesh, si dhe në kushtet kur Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur vetëm një hyrje, si për publikun dhe për prokurorët në kontakt me njerëzit në përditshmërinë e punës, numri i telefonit mund të gjendej mjaft lehtë.

24.7. Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit depozitoi disa procesverbale të seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që i përkasin shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal nr. {***}, viti 2000. Referuar këtyre procesverbaleve, rezulton se në seancat gjyqësore datë 20.06.2001, 02.07.2001 dhe 27.07.2001, nuk u paraqitën as përfaqësuesi i organit të prokurorisë dhe as i pandehuri. Sipas shënimeve në procesverbale, seancat e planifikuara në datat 13.08.2001 dhe 28.09.2001, nuk ishin zhvilluar për arsye të tjera, ndërkohë që në këtë të fundit, datë 28.09.2001, rezulton të jetë paraqitur prokurori A. Ç.. Në seancën vijuese gjyqësore të datës 05.10.2001, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë u përfaqësua nga subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra. Në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se vërtetohet se në katër seanca gjyqësore ka munguar pa asnjë arsye ligjore prokurori A. Ç., duke u bërë shkas për zvarritjen e gjykimit të çështjes. Pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, ka ardhur si rrjedhojë e njoftimit nga kryetari i seancës gjyqësore të drejtuesit të prokurorisë, që në kushtet e drejtimit të centralizuar të prokurorisë, ka urdhëruar verbalisht subjektin e rivlerësimit për të marrë pjesë në gjykim. Pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar se përse këta procesverbalë nuk ishin paraqitur më parë nga subjekti i rivlerësimit, ai iu përgjigj se është njohur me këtë fakt vetëm pas arsyetimit të vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se pjesëmarrja në një seancë gjyqësore të vetme, 20 vjet më parë, për një vepër penale që nuk konsiderohet e rëndë për të mbetur në kujtesën e tij, duke mos qenë as prokurori i çështjes, dhe për të cilën ka kërkuar dënimin me burgim të shtetasit P.A, nuk mund të konsiderohet si kontakt e aq më tepër i papërshtatshëm, sipas nenit 3, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

24.8. Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e depozituara në Kolegj, u qëndroi shpjegimeve të dhëna në Komision, duke e konsideruar absurd informacionin e ardhur nga institucionet e verifikimit, duke sqaruar se nuk është përfshirë kurrë në aktivitetin që pretendohet apo në aktivitete të tjera të kundërligjshme. Nëse institucioni i verifikimit, sipas tij, ka pasur dyshime se subjekti, si prokuror, është përfshirë në këtë aktivitet kriminal, i ka pasur të gjitha mundësitë nëpërmjet metodave speciale të hetimit, si: përgjim, vëzhgim, fotografim, filmim etj., ta verifikonte apo t’ua dërgonte institucioneve të tjera për të kryer veprime procedurale. Institucionet verifikuese, sipas subjektit, e kanë pasur detyrë të informonin menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm dhe të sugjeronin regjistrimin e procedimit penal dhe fillimin e hetimeve ndaj subjektit. Nëse do të ishte dërguar një

³² Në pyetësorin nr. 4, datë 06.10.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

informacion zyrtar për dyshime apo përfshirjen e një prokurori në një veprimtari kriminale, e për më tepër në atë të krimit të organizuar, Prokurori i Përgjithshëm kishte detyrimin ligjor të ndërmerre apo urdhëronte fillimin e procedurave ligjore në lidhje me informacionin zyrtar, dërguar nga institucioni i verifikimit. Në rastin konkret, nuk rezultoi të jetë kryer një veprim apo procedurë e tillë, çka tregon, sipas subjektit, se nuk është vlerësuar prej institucionit të verifikimit si një rast për t'u sugjeruar për ndjekje penale.

24.9. Në vijim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit sqaron se nëse do të kishte lidhje të tjera me këtë shtetas si i përfshirë në trafik, komunikimi me të do të kishte vazhduar nëpërmjet telefonit apo me mënyra të tjera, ndërkohë që sipas tij, rezultoi vetëm një telefonatë, që tregon se ajo ka qenë thjesht rastësore, jo e dalë nga subjekti, pasi po të ishte ndryshe, do të kishte vazhduar komunikimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka informacion se çfarë përmbajtje ka biseda telefonike, nëse bëhet fjalë për trafikim të lëndëve narkotike, korrupsion apo për ndonjë vepër tjetër penale.

24.10. Në lidhje me konstatimin e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, se shtetasi me të cilin është komunikuar, ka qenë i dënuar nga autoritetet italiane, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk ka pasur dijeni se shtetasi me të cilin ka komunikuar, ka qenë i dënuar në shtetin italian për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, nuk ka pasur dijeni se Prokuroria e Krimeve të Rënda kishte hetuar apo filluar ndonjë procedim penal në ngarkim të tij, apo që veprimtaria e shtetasit P. A. të jetë bërë e njohur apo publikuar, apo të jetë dokumentuar në regjistrat përkatës të shtetit shqiptar. Për shkak se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, 14-vjeçare, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është në gjendje dhe normalisht nuk mund t'i kujtohet biseda e zhvilluar me këtë shtetas një herë të vetme dhe për më tepër, kur është telefonuar prej tij. Po kështu, sipas tij, ky shtetas është dënuar në vitin 2010 në Itali, ndërsa komunikimi me subjektin ka ndodhur në vitin 2008, fakt që tregon dhe vërteton plotësisht padijeninë e subjektit për përfshirjen e këtij shtetasi në krimin e organizuar dhe dënimin e mëvonshëm të tij.

Trupi gjyqësor i Kolegjit, ndodhur në kushtet e informacionit të vënë në dispozicion nga organi ligjzbatues, mbi të cilin është hartuar dhe "Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gjon M. Kodra" nr. {***} prot., datë 19.10.2021, i DSIK-së, dhe është bazuar *gjetja* e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar për kriterin e kontrollit të figurës, parë në raport me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, në kuadër të një vlerësimi sa më të drejtë, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të datës 18.07.2022, u njoh në mënyrë të drejtpërdrejtë më datë 21.07.2022, me informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror" që lidhet me praktikën verifikuese të organit ligjzbatues për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.

- 25.** Lidhur me kontrollin e figurës, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik se përfundimi i Komisionit lidhur me kontrollin e figurës, nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm, është i bazuar në fakte dhe ligj. Subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakt të papërshtatshëm jorastësor me shtetasin P. A., i cili rezultoi të jetë person i përfshirë në krimin e organizuar.

25.1. Nga analizimi i rrethanave dhe akteve të kësaj çështjeje, rezultoi i provuar fakti që subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi P. A. kanë pasur një bisedë telefonike mes tyre në vitin 2008. Në kohën kur është kryer kjo telefonatë, ndaj shtetasit P. A., ishte regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 11.10.2007, në Prokurorinë për Krime të Rënda, në bazë të akteve të transmetuara nga Prokuroria Antimafia e Milanos, Itali për veprat penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" dhe "Organizatës kriminale", të parashikuara si krim nga nenet 283/a dhe 333 të Kodit Penal, procedim i cili u pushua më 01.09.2009, pasi autoritetet gjyqësore italiane nuk i kthyen përgjigje letërpërkohësore së dërguar. Nga ana tjetër, sipas akteve të vëna në dispozicion nga vëzhguesi ndërkombëtar, depozituar me *gjetjen* e datës 08.11.2021, të cituar në nënparagrafin 24.5 të këtij vendimi,

autoritetet gjyqësore italiane dënuan shtetasin P. A. për veprat penale “Trafik i paligjshëm i lëndëve narkotike në bashkëpunim” dhe “Themelim, drejtim ose financim i organizatës kriminale në trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike”, të kryera gjatë vitit 2006 në Shqipëri dhe në Itali. Ashtu siç përcaktohet në raportin e DSIK-së dhe në gjetjen e ONM-së, në vlerësimin e kontaktit të subjektit të rivlerësimit, duhet të mbahet në konsideratë rrethana lehtësuese e parashikuar nga neni 38, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, që ka të bëjë me harkun kohor prej më shumë se pesë vitesh më parë nga kontakti dhe faktin që nuk ka ndonjë tregues që ai vazhdon ende. Në kuptim të nenit Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit plotësojnë deklaratën për kontrollin e figurës për periudhën 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, ky përcaktim kushtetues, referuar kohës kur ka ndodhur telefonata, e përjashton subjektin e rivlerësimit nga pasojat e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaramit të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, për mosdeklarimin e kontaktit në vitin 2008, në pjesën 5, germa “c” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016.

25.2. Nga ana tjetër, sa i përket elementit përmbajtësor, për kontakte të mundshme të papërshtatshme përpara periudhës 1 janar 2012, trupi gjykues mban parasysh faktin se nuk provohet në mënyrë të padiskutueshme dijenia e subjektit të rivlerësimit mbi hetimet apo procedimet e ndërmarra nga autoritetet italiane në kohën kur është kryer telefonata, dhe as koha e regjistrimit të këtyre procedimeve. Megjithatë, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale ndaj shtetasit P. A., fakti që ka marrë pjesë në seancën gjyqësore të datës 05.10.2001, në çështjen penale ndaj të pandehurit P. A. për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe, duke pasur parasysh procedimet e ndryshme penale [poshtëshënim nr. 30] ndaj tij, nuk rezultoi të ketë qenë një emër i panjohur për Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nuk mund të pretendohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni të qasjes së këtij shtetasi me organin e akuzës, pavarësisht se procedimet penale ndaj tij janë pushuar. Të gjitha këto rrethana specifike, së bashku me informacionin e disponuar nga organet ligjzbatuese mbi telefonatën e zhvilluar në vitin 2008, në vlerësim të trupit gjykues, nuk mund të mos komprometojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, si dhe nuk mund të lihen jashtë vlerësimit tërësor të kësaj çështjeje.

26. Në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me problematikat e ekzistencës së konfliktit të interesit dhe me kontrollin e figurës, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
27. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji, duke konstatuar mangësi për kriterin e pasurisë, konstatimin e ekzistencës së konfliktit të interesit, së bashku me problematikat për kontrollin e figurës, arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm.
28. Kolegji, në përfundim, çmon se vendimi nr. 491, datë 21.12.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për pasojë ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 491, datë 21.12.2021 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.07.2022.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 31 (JR), datë 27.07.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 491, datë 21.12.2021, dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, por kam mendim paralel lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues për sa parashtruar në vijim.
2. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për pasurinë apartament me sipërfaqe 129 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, ndaj të njëjtin qëndrim si edhe shumica që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë të ardhurat dhe pasurinë e bashkëshortes në deklarin për herë të parë të pasurisë në vitin 2003, si dhe në deklarinet periodike të pasurisë në vitet 2004 dhe 2005, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar), por kam një qëndrim të ndryshëm lidhur me moskonsiderimin e kursimeve në *cash* të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të realizuara nga punësimi i saj për periudhën 1980 – 1999, dhe mospërfshirjen e tyre në përlllogaritjen e burimeve të ligjshme për këtë pasuri, mbështetur në një vlerësim harmonik të rrethanave specifike të kësaj çështjeje, si dhe në faktet e provuara si në vijim.

2.1 *Së pari*, subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. A. L. [shtetase e huaj] më datë 28.08.1999 dhe kjo martesë rezulton e regjistruar në dokumentin “Regjistër themeltar i shtetasve” i arkivës digjitale të Gjendjes Civile, por nuk rezulton e regjistruar në certifikatën e përbërjes familjare, pasi ajo ka qëndruar në Shqipëri me leje qëndrimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin.

2.2 *Së dyti*, fakti që në deklarinin për herë të parë të pasurisë në vitin 2003, si dhe në deklarinet periodike të pasurisë në vitet 2004 dhe 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar jo vetëm kursimet në *cash*, por edhe të ardhurat e bashkëshortes, ndërkohë që për këto vite, kjo e fundit ka përfituar të ardhura nga pension invaliditeti, të provuara me dokumentacion justifikues ligjor³³. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në këto vite edhe pasuritë që bashkëshortja zotëronte veçmas, të cilat nuk rezultonin të regjistruara në regjistrat publikë në Shqipëri. Kjo mënyrë deklarimi e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen dhe kuptimin e tij se bashkëshortja nuk kishte detyrim ligjor për deklarim të të ardhurave dhe pasurive që dispononte veçmas [përfshirë dhe pasurinë likuiditet *cash*]³⁴, duke qenë se ajo ishte shtetase e huaj dhe nuk ishte anëtare e familjes sipas certifikatës së përbërjes familjare. Në vlerësimin tim, ajo që do të çonte në kushtet e moskonsiderimit të kursimeve në *cash* të bashkëshortes në mënyrë të pakundërshtueshme, do të ishte deklarimi nga subjekti i rivlerësimit në këto deklarata periodike në mënyrë të pjesshme vetëm i të ardhurave të sipërcituara të bashkëshortes apo dhe i pasurive të tjera që ajo dispononte veçmas.

2.3 *Së treti*, kursimet nga punësimi i bashkëshortes nuk janë deklaruar apo pretenduar si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 129 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, por ato janë deklaruar më herët:

▪ në deklaratën periodike të vitit 2006, duke qenë se në atë vit është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes së kësaj pasurie; si dhe

³³ Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare në BancoPosta Italiana, “Estrato del conto corrente in Euro, nr. {***}”, e znj. A. L., kreditohet periodikisht në masën e pensionit nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, Itali.

³⁴ Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar).

▪ përpara ILDKPKI-së, në “Shpjegime rreth deklarimit të vitit 2008”, datë 13.05.2010, përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 11.02.2020.

3. Bazuar në rrethanat dhe faktet e provuara më sipër, duke pasur në konsideratë edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e të kuptuarit dhe zbatimit të ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar), si për deklarimin e të ardhurave, ashtu edhe të pasurive/pasurisë likuiditet *cash* që bashkëshortja dispononte veçmas deri në vitin 2006, mospërfshirja e këtyre kursimeve në burimet e ligjshme, do të përlligjej vetëm nëse bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit do të rezultonte me pamundësi financiare për të kursyer shumën 35.000 euro me të ardhura nga punësimi i saj për periudhën 1980 e në vijim. Sipas analizës së kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, bazuar në të dhënat mbi pagat ose të ardhurat, “*Retribuzione o Reddito*”, për periudhën 01.02.1978 deri më 24.02.2003, sipas “*Estratto Conto Previdenziale*” të Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore, Itali, rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. A. L., ka pasur të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe mundësi për të kursyer shumën 35.000 euro për periudhën 1980 e në vijim, ndaj ato duheshin konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 129 m², të ndodhur në {***}, Tiranë.
4. Pavarësisht sa më sipër, sipas analizës së kryer në Kolegj, duke përfshirë si të ardhur të ligjshme kursimet e bashkëshortes të realizuara nga punësimi në vitet 1980-1999, të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2006, në vlerën 35.000 euro, të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit, dekluarar në deklaratën e këtij viti, të ardhurat vjetore të bashkëshortes nga pension invaliditeti, të provuara nëpërmjet lëvizjeve të llogarive bankare të administruara në dosjen gjyqësore, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vitin 2006, në shumën (-) 351.184 lekë; në vitin 2007, në shumën (-) 599.961 lekë; në vitin 2008, në vlerën (-) 530.999 lekë; ndërsa në vitin 2011, në vlerën (-) 341.351 lekë. Në total, diferenca negative e burimeve të ligjshme financiare, sipas përlllogaritjeve në Kolegj, rezulton në vlerën (-) 1.823.482 lekë, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, situatë faktike kjo që passjell konkluzionin se ai ka bërë deklaram të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e po këtij ligji.
5. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, jam dakord me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues që, në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, problematikat e kontrollit të figurës i ka vlerësuar së bashku me ato të ekzistencës së konfliktit të interesit, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por ndaj mendim ndryshe sa i takon cilësimit në konkluzionin e dhënë në paragrafin 25 të vendimit, se *subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakt të papërshtatshëm me shtetasin P. A., i cili rezultoi të jetë person i përfshirë në krimin e organizuar.*
6. Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga organi ligjzbatues, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një komunikim telefonik me shtetasin P. A., i cili nuk mund të ngrihet në nivelin e cilësimit si një kontakt i papërshtatshëm, duke qenë se nuk u arsyetua dhe më tej nuk u konkludua për ekzistencën e një rrethane specifike sipas nenit 38, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila do të passillte për rrjedhojë kualifikimin e kësaj situatë faktike sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në konkluzionet e vendimit, edhe pse ka një cilësim të tillë [si kontakt i papërshtatshëm], ai mbështetet në problematikat që individit P. A. ka pasur me drejtësinë, por jo kërkesës së sipërcituar të ligjit për t’u konsideruar si i tillë në marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit. Pra, konkluzioni në vendim, se subjekti i rivlerësimit ka pasur një kontakt të papërshtatshëm dhe kjo

situatë vlerësohet si cenim i besimit të publikut, bazuar në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, është alogjik, pasi nëse shumica [për këtë qëndrim] kishte krijuar këtë bindje, ajo duhet të kualifikonte këtë situatë faktike sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, kualifikimi i një situatë si cenim i besimit të publikut te drejtësia, në interpretim të përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bëhet për shkaqe e shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara prej këtij neni në pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare relatores Natasha Mulaj, kam ndarë mendim paralel për një nga elementet e trajtuara në vendim për vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, por jam dakord me shumicën në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, për sa parashtror në vijim.
2. Nga analizimi i akteve/provave shkresore të administruara dhe referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, çmuj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte vlerësuar më me objektivitet rrethanat e faktit të kësaj çështjeje, duke mos lënë jashtë vëmendjes ndikimin e disa faktorëve specifikë që i kanë shkaktuar konfuzion subjektit të rivlerësimit lidhur me deklaratimet e të ardhurave dhe kursimeve të bashkëshortes nga punësimi për periudhën 1980-1999, që, në vlerësimin tim, duhet të përfshihen mes burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit të ndodhur në {***}, Tiranë.
3. Sipas dokumentacionit dhe fakteve të provuara përgjatë seancës gjyqësore, rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është shtetase e huaj. Ashtu siç nuk janë deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, apo në deklaratat e interesave privatë periodikë 2004 dhe 2005, kursimet nga punësimi ndër vite, nuk janë deklaruar as të ardhurat e provuara me dokumentacion ligjor gjatë këtyre viteve për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit. Burimi i krijimit të apartamentit nuk është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit, por rezultoi i deklaruar më përpara në kohë, konkretisht në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, kur është porositur apartamenti objekt shqyrtimi. Gjithashtu edhe pranë ILDKPKI-së, me “Shpjegimet rreth deklaratimit të vitit 2008”, datë 13.05.2010. Në përfundim, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nga ana e provueshmërisë, rezultoi se ato janë të ardhura të ligjshme, të mbështetura në dokumentacion të ligjshëm. Analiza e kryer si në Komision, ashtu dhe në Kolegj, tregoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit kishte të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën e deklaruar, prej 30.000 eurosh, në vitin 2006. Fakti i mjaftueshmërisë së konstatuar përforcon argumentin e përfshirjes së këtyre kursimeve si burim i ligjshëm për blerjen e këtij apartamenti.
4. Gjithashtu, ndaj mendim ndryshe për mënyrën e likuidimit të kësteve për apartamentin nga subjekti i rivlerësimit. Vlerësoj se përlllogaritjet duhet të bëhen sipas parashikimit të kontratës së shitblerjes mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese, pasi kontrata e lidhur ka fuqinë e ligjit për palët, ndryshe nga arsytimi i shumicës së trupit gjykues në paragrafin 17.6 të vendimit, në linjë me Komisionin dhe Komisionerin Publik, të cilët e kanë konsideruar shlyerjen e çmimit të apartamentit sipas mandatarkëtimeve dhe deklarimeve në deklaratat e interesave privatë të viteve 2006, 2007 dhe 2008. Është i dukshëm fakti, mosdeklarimi siç duhet i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e tij për krijimin e kësaj pasurie, por gjykata ka detyrim ligjor t'i analizojë provat në bazë të fakteve të provuara, në harmoni me deklaratimet e tij, dhe të arrijë në konkluzionin e duhur.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi